



THIRRJE (II) PËR PJESËMARRJE



Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, organizojnë:

SIMPOZIUMIN SHKENCOR

VENDBANIMET E BASHKISË KORÇË - PROBLEME DHE ZGJIDHJE



(13 Dhjetor 2024)

Në vijim të Konferencës Shkencore “Qendrat e banuara të Shqipërisë – gjendja dhe e ardhmja” (Elbasan, 17 dhjetor 2021), të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe dy universitete: Aleksandër Xhuvani, Elbasan dhe Eqrem Çabej Gjirokastër, do të zhvillohet Simpoziumi Shkencor “Vendbanimet e bashkisë Korçë, problemet dhe zgjidhja”, frut i bashkëpunimit të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në zbatim të konkluzioneve të kësaj konference, simpoziumi shkencor, duke u fokusuar në metodologjinë e analizës shkencore të problemeve komplekse të vendbanimeve të bashkisë së Korçës, çel rrugën e studimit të qendrave të banuara të vendit tonë. Ai shënon fillimin e zbatimit të projektit studimor “Vendbanimet e Bashkisë së Korçës”, të drejtuar nga Departamenti i Histori-Gjeografisë të Universitetit të Korçës.

TEMAT E REFERENCËS

- Pozita gjeografike si bazë për lindjen, zhvillimin, jetëgjatësinë dhe shpërndarjen e vendbanimeve në Bashkinë e Korçës.
- Roli i kushteve gjeografiko-natyrore (relievi, klima, ujërat, pasuri minerare, bota e gjallë, trashëgimia natyrore, rreziqet natyrore) në lindjen, shpërndarjen dhe evolucionin e vendbanimeve në bashkinë e Korçës; mundësitë e komunikimit, marrëdhëniet me vendbanimet e hapësirat e afërta e të largëta.
- Faktorët gjeografiko-historikë e kulturorë në krijimin e funksionimin e vendbanimeve. Historia e popullimit, lindja dhe etimologjia, fazat historike të zhvillimit dhe të evolucionit deri sot.
- Popullsia, vendbanimet dhe politikat demografike; ecuria e numrit të popullsisë, përqendrimit e saj; shtimi natyror, migrimet dhe faktorët natyrorë, socialë, politikë, shëndetësorë etj., pasojat e tyre; strukturat sasiore e cilësore të popullsisë, grupet etnike; cilësia e jetës, gjendja sociale, shëndetësore e arsimore; kultura, traditat; trashëgimia kulturore (materiale dhe jomateriale).
- Klasifikimi i vendbanimeve sipas origjinës, vendndodhjes dhe funksioneve. Vendbanim i vjetër apo i ri, fushor, kodrinor apo malor, me funksione banimi, pushimi, prodhues, aktivitete shërbimi, kompleksi i botës së punës të qytetit/fshatit. Tipologjitë bazë të funksioneve, roli dhe perspektiva e tyre funksionale; tipi i

qendrës së banuar: qytet/fshat, administrative, industriale, bujqësore, turistike, tregtare, universitare etj. Vendbanimet rurale dhe cilësia e peizazhit.

-Procesi i urbanizimit në Bashkinë e Korçës nën sisteme të ndryshëm ekonomiko –shoqërore. Diferencime në kohë dhe hapësirë. Rrethanat historike të lindjes, zhvillimit, ekzistencës dhe shpërndarjes së vendbanimeve të kategorive/tipologjive të ndryshme. Qytet smart (Smart City) dhe qytet ekologjik (Eco City).

Vendbanimet e braktisura dhe dilema e mbijetesës së tyre pas vitit 1990. Faktorët e mundësitë e rivitalizimit/rifunksionimeve të tyre. Morfologjia urbane/rurale, tipologji/tiparet e zhvillimet materiale të objekteve/lagjeve, zonimi funksional hapësinor/modele, gravitacioni urban, lëvizjet pendulare etj.

- Vendbanimet e territori, resurset humane dhe proceset urbanizuese.Vendbanimet dhe përdorimi i tokës, evolucioni i tyre, peizazhi dhe probleme të artitekturës së tij. Potenciali human e gjendja social-ekonomike, të ardhurat, prirjet, profili ekonomik/funksional, ndryshimet hapësinore e strukturore.

- Ekonomia e vendbanimeve, historia dhe aktivitetet e sotme prodhuese, sigurimi i të ardhurave; struktura e prodhimit në qytet e fshat. Mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm në bazë të potencialeve natyrore, humane e ekonomike. Rivitalizimet urbane/rurale dhe zhvillimet turistike me fokus historik dhe të viteve të fundit. Mbatja e lidhjeve dhe rikthimi i banorëve të larguar. Koshienca regjionale e popullsisë në vendbanimet rurale dhe urbane.

- Probleme të administrimit të vendbanimeve. Reformat e ndryshme territoriale dhe efektet e tyre në menaxhimin e territorit. Evolucioni hapësinor i njësive administrative dhe probleme.

- Përdorimi i GIS-it në planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të qendrave të banuara.

DATA TË RËNDËSISHME

Konfirmimi për pjesëmarrje me referim deri:	30 korrik 2024
Afati i fundit për dorëzimin e abstraktit:	08 nëntor 2024
Njoftimi i pranimit të referimit:	15 nëntor 2024
Simpoziumi:	13 dhjetor 2024
Dorëzimi i artikujve të plotë deri:	25 mars 2025

KOMUNIKIMI DHE DËRGIMI I ABSTRAKTEVE NË ADRESAT ELEKTRONIKE:

Prof. as. dr. Jostina Dhimitri

Tel: 0692264796; Email: jostina.dhimitri@unitir.edu.al

Dr. Ermiona Braholli

Tel: 0692122266; Email: ermiona.braholli@yahoo.com

KËSHILLI SHKENCOR DHE ORGANIZUES

Prof. dr. Perikli Qiriazhi

Prof. dr. Skënder Sala

Prof. dr. Bilal Draçi

Prof. dr. Dhimitër Doka

Prof. dr. Niko Rogo

Prof.as.dr. Merita Koka Karaguni

Prof.as.dr. Jostina Dhimitri

Prof.as.dr. Benita Stavre

Prof.as.dr. Edlira Menkshi

Prof.as.dr. Alba Kreka

Dr. Ermiona Braholli

Dr. Ermira Jashiku

Dr. Adelina Nexhipi

Ph.D. Metin Venxha

Dr. Orion Ago

Ph.D. Marçela Mele

EVENTI DHE KOHA

Simpoziumi do të zhvillohet në datën 13 dhjetor 2024, në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S, Noli”, Salla “Teodor Laço”. Adresa: Bulevardi “Rilindasit”Korçë.